



Nr. 1033/1 Prot

Tirane me 7/06/2002

**L e n d a : Për shkelje të ligjit në rivendosjes në afat të ankimit kundër vendimeve të konvertimit të dënimit të Gjykatave të huaja.**

**PROKURORIVE PRANË  
GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË**

**PROKURORIVE PRANË  
GJYKATAVE TË APELIT**

Me shkresën Nr. 238 datë 29. 05, 2002, dërguar Inspektoratit të K.L.D-së dhe për dijëni Ministrin të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, Kryetari i Gjykatës së Lartë, tërheq vëmendjen për shkelje të ligjit, në Gjykatat e shkallës së parë dhe në Gjykatat e Apelit, për rastet e rivendosjes në afat të së drejtës, për të kundërshtuar në Apel vendimin e Gjykatës shkallës së parë shqiptare, që ka konvertuar sipas ligjit shqiptar, vendimin e dënimit penal të dhënë nga një gjykatë e huaj, pas ekstradimit/transferimit të të dënuarit, për të vuajtur dënimin në Shqipëri.

Gjithashtu, ndaj gjyqtarit Elvis KOTINI, Gjykata e shkallës së parë Tiranë, është kërkuar fillimi i procedimit disiplinore, për shkelje të rënda të ligjit, sepse:

- me vendimin e tij Nr. 616 Akti, datë 29. 10. 2001, ka pranuar kërkesën për të rivënë në afat të drejtën e ankimit kundër vendimit Nr. 10 Akti, datë 5. 10. 2000 të Gjykatës së rrethit Tiranë, mbi njohjen e vendimit penal Nr. 651 datë 21. 09. 1999 të Gjykatës së Apelit Selanik-Greqi.

Në kontrollet e ushtruara në vitin 2001 është evidentuar, gjithashtu, se ka patur edhe raste të tjera, që mbi ankimin e të dënuarve, pas njohjes së vendimit nga gjykatat shqiptare dhe transferimit të tyre, kryesisht nga

Greçia, për vuajtjen e dënimit në Shqipëri, në disa Gjykata të shkallës së parë dhe Gjykatat e Apelit Tirane, Vlorë etj, janë shqyrtuar çështje, për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit dhe për njohje të vendimeve penale të huaja.

- Në disa nga këto çështje edhe mbi kërkesën e prokurorëve, gjykatat kanë ndryshuar/zbutur dënimet e njohura më parë nga gjykatat shqiptare të të dënuarve të transferuar nga Greçia në Shqipëri.

Kjo praktikë e gabuar ligjore, në disa kërkesa të prokurorëve dhe në disa vendime gjyqësore, për ndryshimin e vendimeve penale të huaja, në fazën e ekzekutimit, pasi vendimet penale janë njohur e pranuar me vullnetin e të dy shteteve, bie në kundërshtim me nenet 488-523 e vijues të K. Pr. Penale dhe me Konventën "Për transferimin e personave të dënuar", ratifikuar me ligjin N~r, 8499 date 10. 06. 1999, etj., si dhe përbëjnë një precedent të rrezikshëm, që mund të sjell pasoja serioze në marrëdhëniet juridiksionale/proceduese të shtetit Shqiptar me autoritet e huaja.

Ju dërgojmë, si praktikë gjyqësore, vendimin Nr. 57 datë 23. 01. 2002, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në pjesën arsyetuese të të cilit, krahas trajtimit dhe analizës, mbi bazën ligjore të zgjidhjes së çështjes objekt rekursi, janë parashtruar edhe argumente ligjorë lidhur me aplikimin e gabuar të K. Pr. Penale dhe Konventave të pranuar, siç janë:

1. Rivendosja në afat e të drejtës së të dënuarit, për të kundërshtuar në Apel vendimin e Gjykatës shkallës së parë shqiptare, që ka konvertuar sipas ligjit shqiptar, vendimin penal të një gjykate të huaj, është bërë në kundërshtim me ligjin, duke arsyetuar se:

- 1.1. në bazë të nenit 147/2 të K. Pr. Penale të drejtën për të kërkuar rivendosje në afat, për të bërë ankim, e ka i pandehuri që provon se nuk ka marrë dënimin për vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë;

- 1.2. kusht i Konventës dhe i ligjeve të dy shteteve është bërja e kërkesës nga i dënuari, për ekstradimin/transferimin e tij, për efekt të vuajtjes së dënimit me burgim të mbetur, në vendin e origjinës, neni 489 i K. Pr. Penale dhe neni 6 i Konventës Evropiane "Për Ekstradimin", viti 1957, ratifikuar me ligjin Nr. 8322 datë 2. 04. 1998.

- 1.3. transferimi i të dënuarit nga Greçia në Shqipëri ka qenë rezultat i të gjitha procedurave që janë të përmendura në vendim dhe gjithashtu, **transferimi është shprehje e vullnetit të vetë kërkuesit**

Në këto kushte, arsyetohet në vendim se: **"nuk mund të pretendohet nga i dënuari i transferuar dhe për pasojë, as të pranohej nga gjykata, se ai nuk ka dënimin për vendimin e Gjykatës së shkallës së parë, që ka njohur vendimin e gjykatës greke, e për pasojë të kërkojë e të rivendoset në afat e drejta për ta ankimuar atë".**

2. Gjykata që njeh dhe konverton vendimin e dhënë nga një autoritet i huaj, nuk ka për detyrë të rivlerësojë rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat kanë qenë objekt i shqyrtimit nga autoriteti kompetent që ka gjykuar **çështjen në themel, por vlerëson nëse caktimi i dënimit i përgjigjet nga natyra e tij, vendimit të huaj.**
3. Pranohet, nga Kolegji Penal, gjithashtu, se është vendimi i huaj ai që do të zbatohet në shtetin Shqiptar dhe se **detyra e organeve proceduese shqiptare është të vlerësojë:**
  - 3.1. nëse vendimi i huaj është dhënë në përputhje me parimet e njohura për një gjykim të drejtë e të paanshëm;
  - 3.2. nëse janë respektuar të drejtat e liritë e të gjykuarit në atë procedim;
  - 3.3. nëse ka ndonjë shkak për mospranimin e kërkesës për ekstradim dhe më tej të konvertojë dënimin e huaj me një vendim shqiptar për efekt të ekzekutimit të tij

Në **vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 154 datë 15. 04. 2000, Fletore Zyrtare Nr. 48, viti 2000,** është pranuar se në procesin e njohjes dhe të caktimit të dënimit, gjykatat të bëjnë **kujdes që dënimi, i cili do të vuhet në territorin shqiptar, Vi përgjigjet për nga natyra vendimit të huaj dhe jo të rivlerësojë këtë të fundit në komponentët e tij.**

Me këtë qarkore të njihen prokurorët e të gjithë niveleve. Drejtuesit e Prokurorive pranë Gjykatave të shkallës së parë dhe pranë Gjykatave të Apelit, të marrin masat e duhura, për të kontrolluar dhe ndihmuar prokurorët, në zbatimin e ligjit dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, për raste të pjesëmarrjes së tyre në gjykimin e çështjeve që janë të lidhura me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, me synim që në të ardhmen të shmangen qëndrimet e evidentuara të prokurorëve, në zbatim të gabuar të ligjit.

Bashkëlidhur dy vendimet e lartpërmendura të Gjykatës së Lartë.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**THEODHORI SOLLAKU**



